



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Nr. 320-16136/19

Klinë, me 23.04.2019

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e kulturave perimore (ngritja e serrave)

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë-perimekulturës, Komuna e Klinës respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural publikon :

SHPALLJE

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ngritjes së serrave në sipërfaqe prej 50 m². dhe 100 m²

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj me:

- Financim 70 % të kostos së serrës
- Këshillime profesionale dhe monitorim të vazhdueshëm të fermerëve përmes ekspertëve të kësaj drejtorie.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë qytetar i komunës së Klinës
2. Të ketë njohuri evidente në kultivimin e perimeve
3. Të posedoj sipërfaqe tokësore të mjaftueshme për vendosjen e serrës
4. Të ketë mundësi ujitje për serrë
5. Të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30% të mjeteve financiare në koston e serrës
6. Përparësi kanë fermerët, të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e komunës, të Ministrisë së Bujqësisë dhe donacione tjera
7. Përfituesit e serrave janë të obliguar ti përmbahen kontratës 3 vjetarë

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa për aplikim merret në arkiv dhe plotësohet nga vete fermeri
2. Fleta poseduese
3. Vërtetimi i tatimit në pronë
4. Letërnjoftimi kopje

Afati i aplikimit nga data 23.04.2019 deri me 02.05.2019

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e arhivës komunale dhe regjistrohet në protokollin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Klinë.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtori
Naser Morina

